



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



FFDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

Nr. 080 Dt. 09.03.2022
PRISHTINË • PRIŠTINA • PRISTINA

Federata e Basketbollit të Kosovës

+383 49 703 888
federata@basketbolli.com

Lagja "Arbëria"
Blok C3, Faza 2
Str. Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

RREGULLORE E GARAVE PËR 3x3

22.02.2022, Prishtinë

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Youth Basketball sponsors:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit të Kosovës

+383 49 703 888
federata@basketboll.com

Lagja "Arbëria"
Billoku C3, Faza 2
Str. Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Në bazë të neneve 1.2, 22.1, 33.1, 33.3 dhe 34, Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës miraton këtë Rregullore të Garave për basketbollin 3x3

KREU I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 – Qëllimi i Rregullores së Garave

Rregullorja e Garave (në tekstin e mëtejme Rregullorja) përcakton kriteret themelore për organizimin e garave të basketbollit 3x3 në të gjitha kategoritë dhe grupmoshat, sistemin e garave dhe kriteret e përgjegjës së ekipeve nacionale të Kosovës në 3x3.

Neni 2- Organizatorët e garave

2.1 Të gjitha garat e 3x3 administrohen dhe mbikëqyren nga Federata e Basketbollit e Kosovës (në tekstin e mëtejmi FBK) nëpërmjet platformave zyrtare të FIBA-s. Organizator i garave zyrtare të 3x3 në Kosovë mund të jetë çdo person juridik (në tekstin e mëtejmi promotor), që autorizohet nga FBK, përbush kriteret e kësaj rregulloreje dhe të FIBA-s për organizim të garave 3x3.

2.2 FBK mund të emërojë një person ose një komision përgjegjës për administrim dhe mbikëqyrje të garave në 3x3, dispozitave të kësaj rregulloreje ose akteve tjera normative që rregullojnë garat ose përfaqësimin ndërkombëtar në 3x3.

2.3 Obligimet e FBK-së dhe promotorëve përcaktohen sipas formulës në vijim:

Obligimet e promotorëve:

	Kategoria A	Kategoria B
Kategori të Garave	minimum 2	minimum 1
Fusha speciale për 3x3	e obligueshme	e preferueshme
Topi special për 3x3	e obligueshme	e obligueshme
Koshi me standarde FIBA	e obligueshme	e preferueshme
Zërim dhe konferencier	e obligueshme	e preferueshme
Semafori elektronik	e obligueshme	semafori i preferueshëm/ kronometri i obligueshëm
Ujë për pjesëmarrësit	e obligueshme	e obligueshme

Supported by:



General Sponsor:



Goldë Sponsor:



Silver Sponsor:



Youth Basketball sponsors:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOSARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit të Kosovës

+383 49 703 888
federata@basketball.com

Lagja "Arbëria"
Billoku C3, Faza 2
Str. Radovan Zogoviç
10 000 Prishtina

Fotograf zyrtar	e obligueshme	e preferueshme
Shujtë për gjyqtarët	e obligueshme	e preferueshme
Fanella për lojtarët	ekipet garojnë me fanella të veta	e obligueshme
Policia/sigurimi	e obligueshme	e obligueshme
Lajmërimi në FIBA	e obligueshme	e obligueshme
Fond i shpërblimeve	e obligueshme	e preferueshme

Çka ofron FBK?

Vendosja në kalendar të garave	e obligueshme
Poentimi për Turne Final	e obligueshme
Gjyqtarë dhe delegatë	e obligueshme
Përkrahje mediale	e obligueshme
Lehtësi në lajmërim të ekipeve	e obligueshme
Topa zyrtarë	me kërkesë/marrëveshje
Kosh me standarde të FIBA-s	me kërkesë/marrëveshje
Semafor elektronik	me kërkesë/marrëveshje

KREU II – GARAT

Neni 3 – Grupmoshat dhe kategoritë

Për nevojat e kësaj Rregulloreje, kategoritë dhe grupmoshat që marrin pjesë në gara zyrtare të 3x3 në Kosovë dhe për të cilat mund të organizohen kampionate shtetërore me sisteme përkatëse të garave janë:

- a) Kategoria U12
- b) Kategoria U15 meshkuj – U15 femra
- c) Kategoria U18 meshkuj – U18 femra
- d) Kategoria U20 meshkuj – U20 femra
- e) Seniorët – Senioret
- f) Veteranët (lojtarët më të vjetër se 35 vjeç) – veteranet (lojtaret më të vjetra se 30 vjeç)

Supported by:



General Sponsor:



Goldia Sponsors:



Silver Sponsors:



Youth Basketball sponsors:





Neni 4 – Turnetë në 3x3

4.1 Të gjitha turnetë e 3x3 konsiderohen zyrtarë vetëm nëse lajmërohen në platformat përkatëse të FIBA-s dhe marrin statusin FIBA Endorsed. Pas sigurimit të statusit FIBA Endorsed, turnetë lajmërohen në FBK, inkorporohen në kalendar të garave dhe poentohen nga FBK për radhitje të ekipeve.

4.2 Turnetë që marrin statusin FIBA Endorsed, për nevoja të kësaj rregulloreje kategorizohen si në vijim:

4.2.a Turnetë e kategorisë A (12 ose më shumë ekipe M, 8 ose më shumë ekipe F)

4.2.b Turnetë e kategorisë B (11 e më pak ekipe M, 7 ose më pak ekipe F)

4.2.c Turneu Selektiv – turneu ku bëhet përgjedhja e ekipeve nacionale të Kosovës për FIBA Europe Cup, ose gara tjera të FIBA-s sipas kalendarit të FIBA-s ose vendimit të Bordit të FBK-së

4.2.d Turneu Final – turneu ku marrin pjesë ekipet më të mira të sezonit të rregullt, të ranguara sipas poentimit të FBK-së. Ky turne organizohet nga FBK dhe fituesi i këtij turneu në kategorinë përkatëse e fiton titullin e Kampionit të Kosovës në 3x3.

4.2.e Turnetë e kategorive të reja – të gjithë turnetë, përfshirë ata të organizuar nga shkollat ose organizatat e sportit të shkollor, ku marrin pjesë lojtarët e kategorive të reja, të definuara në nenin 3 të kësaj rregulloreje.

4.3 Të gjitha turnetë dhe garat tjera që organizohen në Kosovë, e kanë statusin FIBA Endorsed dhe mbikëqyren e administrohen nga FBK, mund të definohen me Propozicione të Garave të veçanta ose vendime të Bordit të FBK-së.

Neni 5 – Kalendar i Garave

5.1 FBK miraton kalendarin e garave të 3x3 dhe obligohet që të përcaktojë qartë pjesën e sezonit të rregullt dhe Turneut Final.

5.2 Sezoni i rregullt zgjatë së paku 6 muaj kalendarikë. Në sezoni e rregullt mund të organizohen numër i pakufizuar i turneve, përderisa u përbahen disa kriterieve themelore:

5.2.a Secili turne duhet ta ketë statusin FIBA Endorsed dhe të raportohet me rregull në platformat e FIBA-s dhe të FBK-së, para, gjatë dhe pas përfundimit të garave

5.2.b Secili turne me statusin FIBA Endorsed duhet të lajmërohet në FBK, së paku 30 ditë para datës së zhvillimit

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:





5.2.c Në turne garojnë vetëm lojtarët dhe ekipeve lajmëruara në platformat zyrtare të FIBA-s

5.3 Turneu Final organizohet nga FBK pas përfundimit të sezonit të rregullt. Në Turneun Final marrin pjesë 12 ekipe më mira të meshkujve dhe 8 ekipe më të mira të femrave në grup moshën e seniorëve. Fituesit të Turneut të Final në kategorinë përkatëse i takon titulli i Kampionit të Kosovës në 3x3.

5.4 Afatet për lajmërimin e ekipeve pjesëmarrëse në secilin turne bëhen publike, së paku 10 ditë para fillimit të turneut. FBK mirëmban një sistem të online të aplikimit të ekipeve dhe lojtarëve, kurse promotori i secilit turne obligohet që të gjitha ekipe pjesëmarrëse dhe rezultatet e tyre ti lajmërojë në platformat zyrtare të FIBA-s.

Neni 6 – Sistemi i Garave

6.1 Turnetë e Kategorisë A dhe B – orari i turneut dhe radhitja e ekipeve në grupe bëhet sipas shortit dhe procedurave që përcakton platforma zyrtare e FIBA-s.

6.2 Turnetë e kategorive të reja - orari i turneut dhe radhitja e ekipeve në grupe bëhet sipas shortit që hedhet para fillimit të garave.

6.3 Turneu Final - orari i turneut dhe radhitja e ekipeve në grupe bëhet sipas shortit dhe procedurave që përcakton platforma zyrtare e FIBA-s dhe rangimi i ekipeve, sipas poentimit të FBK-së për turnetë zyrtare.

6.4 Poentimi i ekipeve në turnetë zyrtare të të gjitha grupmoshave bëhet, sipas formulës në vijim:

Turne i kategorisë A

Pozita	Pikë
1	25
2	21
3	18
4	16
5 – 8	10
9 – 12	5
12 – 24	2
25 e tutje	1

Supported by:



General Sponsor:



Goldia Sponsors:



Silver Sponsors:



Youth Basketball sponsors:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit të Kosovës

+383 49 703 888
federata@basketboli.com

Lagja "Arbëria"
Billoku C3, Faza 2
Str. Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Turne i kategorisë B

1	10
2	6
3	4
4	3
5 – 8	2

Neni 7 – E drejta e garimit – lojtarët dhe ekipet

7.1 Të drejtë të pjesëmarrjes në turnetë zyrtare të 3x3 kanë të gjithë lojtarët që janë të regjistruar në platformën <http://play.fiba3x3.com/> jo më vonë se një ditë para fillimit të turneut.

7.2 Një ekip përbëhet nga 4 lojtarë dhe përbërja e ekipave lajmërohet në platformën zyrtare të FIBA-s. Në rast se ekipi ndryshon lojtarët gjatë sezonit, për rangim të ekipave shërben kumulativi i pikëve që tre lojtarëve më të mirë të ekipit në rang-listën e FIBA-s. Ekipet që plasohen në Turneun Final duhet të kenë në përbërje së paku 3 lojtarët e vet më të mirë, sipas rang-listës së FIBA-s dhe të cilët kanë marrë pjesë në gjysmën ose më shumë të turneve me të njëjtin ekip.

7.3 Ekipet që nuk i përbahen dispozitës 7.2, e humbin të drejtën e përfaqësimit në Turneun Final. Zëvendësimi i tyre bëhet me ekipin/et pasuese në rang-listën e FBK-së.

KREU III – DISPOZITAT DISIPLINORE

Neni 8 – Regjistrimi i ndeshjeve

Regjistrimi i rezultateve të ndeshjeve dhe radhitjeve në turne është obligative të bëhet në platformat e FIBA-s. Koordinatori i FBK-së për 3x3, i regjistron rezultatet dhe përditëson rangimin e ekipave në bazë të sistemit të FBK-së për poentim.

Neni 9 – Mos zhvillimi i ndeshjes

Promotorët dhe personat zyrtarë të FBK-së janë të obliguar që brenda mundësive dhe dispozitave normative në fuqi, të bëjnë të gjitha përpjekjet për zhvillimin e ndeshjeve dhe turneve.

Supported by:



General Sponsor:





Goldëne Sponsors:



Silver Sponsors:



Youth Basketball sponsors:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit të Kosovës

+383 49 703 888
federata@basketbolli.com

Lagja "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str. Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Në rast se ndeshja nuk zhvillohet për shkak të kushteve ekstreme meteorologjike, fatkeqësive, katastrofave natyrore ose rasteve tjera që konsiderohen fuqi madhore (vis maior), ndeshja duhet të përsëritet në termin që e cakton Koordinatori i FBK-së për 3x3.

Në rast se një ekip nuk paraqitet në ndeshje pa arsyen (në kohën e caktuar për zhvillimin e ndeshjes, nuk i ka në dispozicion tre lojtarë të gatshëm për lojë), ose përashtohet nga ndeshja/turneu, atëherë të gjitha rezultatet e këtij ekipi, humben me Ë-0 për ekipin kundërshtar dhe i takojnë 0 pikë në radhitjen e turneut.

Kur ndeshja regjistrohet me Ë-0 ekipit fitues i takojnë pikët në radhitje si fitues, por ky rezultat nuk merret parasysh në llogaritje të kosh diferençës, apo parametrave tjerë në renditje ose statistika.

Humbja e dy ndeshjeve me Ë-0, rezulton me përashtim automatik nga turneu.

Neni 10 – Ndërprerja e ndeshjes

10.1 Në rast se ekipi nuk e ka asnjë lojtar të gatshëm për lojë (lëndime/diskualifikime) e humbë ndeshjen me automatizëm.

Nëse ekipi mbetet pa lojtarë në fushën e lojës, e humbë ndeshjen dhe në rast se kjo situatë përsëritet, përashtohet nga turneu. Ekipi që ka lojtarë të gatshëm në fushë, është fitues i ndeshjes dhe ka mundësi të zgjedh me cilin rezultat evidentohet ndeshja.

Opsioni 1: rezultati në momentin e ndërprerjes

Opsioni 2: regjistrimin e ndeshjes me Ë-0.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Youth Basketball sponsors:





10.2 Nëse një ekipi i përjashtohet më shumë se një lojtar në një ndeshje, ekipi përjashtohet nga turneu me automatizëm.

Neni 11 – Renditja e ekipeve

11.1 Renditja e ekipeve bëhet në bazë të rezultateve të arritura në fushën e lojës, ose në bazë të rezultateve që parashihen në Kreun III të kësaj rregulloreje.

Në rast se ekipet kanë numër të njëjtë të pikëve, rangimi i tyre bëhet sipas këtij kriteri:

a. Nëse dy ekipe kanë të njëtin numër pikësh, renditja e tyre përcaktohet nga rezultati ndeshjet e ndërsjella;

b. Nëse tri ose më shumë ekipe kanë të njëtin numër pikësh, së pari vendoset numri i fitoreve në renditje ndeshjet e ndërsjella;

c. Nëse rendi përfundimtar nuk merret sipas kriterit nga pika b, vendos numri mesatar kosha të dhëna në të gjitha ndeshjet në grup;

d. Nëse rendi përfundimtar nuk merret sipas kritereve nga pika c, vendos numri total i pikëve

3 lojtarët më të mirë të renditur të ekipit në faqen e internetit <https://play.fiba3x3.com/> një ditë më parë konkurenca (me rastin e përcaktimit të grupeve para garës);

e. shorti

11.2 Një ekip i përjashtuar nga një turne, mund të marrë pjesë në turneun e ardhshëm në kalendarin e FBK-së, me përjashtim të rastit të ndalesës kohore të paraqitjes për ekipin apo lojtarin/ët.

Neni 12 – Ndërprerja e ndeshjes - incidenti

Nëse gjyqtari i parë vendos të ndërpres ndeshjen për shkak të një incidenti në fushë, ndeshja do të regjistrohet me rezultatin ë (fitore): 0 në favor të ekipit që nuk ishte fajtor për incidentin. Ekipi që humbi ndeshjen, përjashtohet nga gara dhe nuk i fshihen rezultatet nga ndeshjet e zhvilluara në turne.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Youth Basketball sponsors:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOSARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit të Kosovës

+383 49 703 888
federata@basketbolli.com

Lagja "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str. Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

KREU IV – EKIPET PËRFAQËSUESE

Neni 13 – PJESËMARRJA NË EKIPE PËRFAQËSUESE

Anëtarët e ekipeve kombëtare përzgjidhen nëpërmjet turneut selektiv dhe/ose rangimit të lojtarëve në rang-listën e FIBA-s.

Ekipet përfaqësuese të 3x3 i nënshtrohen dispozitave të Rregullores për Përfaqësuese të FBK-së dhe kritereve e rregullave të FIBA-s për përfaqësim në gara ndërkombëtare.

KREU V – DISPOZITAT KALIMTARE E PËRFUNDIMTARE

Neni 14 – Zbatimi i akteve tjera normative

Për situatat që nuk parashihen në këtë rregullore, vlejnë dispozitat disiplinore të akteve normative të FBK-së dhe dispozitat sportive dhe të Rregullave të Lojës të FIBA-s.

Neni 15 – Interpretimi

Interpretimin e kësaj rregulloreje në shkallë të parë e bën Koordinatori i FBK-së për 3x3. Në shkallë të dytë interpretimin e Rregullores e bën Bordi i FBK-së.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Youth Basketball sponsors:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit të Kosovës

+383 49 703 888
federata@basketbolli.com

Lagja "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str. Radovan Zogoviç
10 000 Prishtina

Leart Hoxha - Koordinator i FBK-së për 3x3

Arben Fetahu - Kryetar i FBK-së

DR

Arben Fetahu



Federata e Basketbollit të Kosovës

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Youth Basketball sponsors:

